

Me parandalua zjarrndezje në shtëpi

Tre prej katër lëndimeve të zjarrit ngjasin në banesa. Pothuaj çdo herë është mungesë vëmendjeje që shkakton zjarr por edhe gabime teknike janë shkaqe të zakonshme zjarri. Sjell ndër mend që gjithmonë është më lehtë të parandalohet se të fiket zjarri.



SHKAQE ZJARRI NË SHTEPI

GABIME ELEKTRIKE

Në shtëpitë tona ka pajisje elektrike të të gjitha llojeve. Këto aparate mund të shkaktojnë zjarr nga shkaku se ato tejnxehen ose përdoren gabimisht. Nëse ti ndjen kundërmime të dyshimta ose dëgjon zëra nga sistemi i korrentit është mirë të kontaktosh një elektrikist. Kur kabllët dhe pajisjet elektrike duhen ndreçur, është gjithmonë më mirë nëse puna bëhet nga një specialist. Përndryshe janë ato masat e zakonshme të rutinës që duhen marrë për të parandaluar zjarre elektrike. Mbylle gjithmonë TV-rin me çelës elektrik e mos lejo që makinat tharëse, robbat-ose makinat larëse të enëve të jenë të ndezura kur e lë shtëpinë apo kur flë.

Mos terr kurr roba në radiator ose në agregatin e saunës. Bëre si rregull ta nxjerrësh jashtë prizën e kontaktit kur ti përdorë theksën e bukës dhe hekurin.

Instalo me gjithë qejf një ndërprerëse të rrymës për defekte tokëzimi.

QIRINJ TË NDEZUR DHE ZJARR TË HAPUR

Qirinjtë të ndezur të harruar shkaktojnë shumë zjarre në shtëpitë tona. Mos i vendos qirinjtë shumë afër perdeve ose mbi TV-or. Përdor shandane të "materialit të mire" psh. qeramikë, qelq ose llamarinë. Mos përdor shandane druri. Ta bësh si rregull që kurr të mos e lëshosh një dhomë me qirinjtë të ndezur ose me zjarr të hapur. Fiki ato sëpari.

Në të gjitha kohërat fëmijët kanë qenë kureshtarë në zjarre. Nga ky shkak është me rëndësi që fëmijët të mësohen të përdorin zjarrin në një mënyrë të natyrshme. Mos tento kurr ta frikësosh një fëmijë me zjarr- kjo ngrit edhe më shumë kureshtjen. Mos i lë kurr fëmijët vetëm me qirinjtë të ndezur ose me zjarr të hapur.

PIRJE DUHANI

Pirja e duhanit është shkaku më i rëndomtë me pasojë vdekjepruese. Nuk është vetëm pirja e duhanit në krevat që është e lidhur me rrezikun për jetë. Është gjithashtu rrezik të flihet nga cigarja në një kolltuk ose sofë. Një gjë tjetër me rëndësi është që përmbajtja në taketuke të laget, para se të zbrazët ajo.

KUZHINA MUNDET TË JETË NJJË RREZIK ZJARRI

Shumica e zjarreve fillojnë në stufë. Zierja e tharrë është një shkak i zakonshëm zjarri. Yndyrat ose vajrat fillojnë të digjen kur temperatura ngritet si edhe stearina. Mos le pra diçka që vlon mbi stufë, kur ti del jashtë nga kuzhina.

Një kohëmatës që ndërpret rrymën në stufë dhe në aparat për kafe do ishte mire të instalohen. Veç kësaj duhet munduar që ventilatori të mbahet sa më pastër sa të jetë e mundur, gjë që është një mënyrë e mire për ta pakësuar rrezikun e zjarrit në kuzhinë. Yndyra dhe bloza ndizen pra shumë lehtë.

MALLRA TË RREZIKSHME ZJARRI

Mallra tepër të rrezikshme zjarri janë benzina, T-sprit, vajguri dhe tretësira ndezëse. Ruaji këto tretësira në enë të përshtatshme dhe në vende ku fëmijët nuk mund t'i arrijnë.

Ndeze skarën ose të ngjashme me tretësirë për ndezje. Mos përdor kurr benzinë ose T-sprit.

Mos hedh kurr shishe spreji në zjarr të hapur. Ajo mund të plasi me fuqi!

Gazoli është një gaz shumë i rrezikshëm zjarri e nga ky shkak është me rëndësi që ai të zotërohet. Mbylle ventilin në shishen e gaazolit kur gazi nuk vëhet në përdorim. Nëse ke gazol në barkë ose në furgon është pra me rëndësi të kontrollohen shpesh ndërlihdjet, ventilët ose zorrët që të mos jenë të dëmtuara.

ZJARRE ME QËLLIM

Zonat banesore goditën shpeshherë nga zjarret me dashje. Mënyra më e mire për ta penguar këtë është që të mos mbahen materiale të ndezshme në shkallë të shtëpive ose në vende tjera që arrihen lehtë. Është gjithashtu me rëndësi të mbahen të mbyllura trapazanet, qilarët dhe garazhet dhe t'i kushtohet kujdes ndriçimit që të funksionojë.

Këto janë masa që vështirësojnë për atë që vë zjarr me qëllim.

PËR NDIHMËN TËNDE

ALARMUES ZJARRI

Në rast zjarri është pra tymi që është më i rrezikshmi dhe i cili shkakton raste të vdekjes.

Pajisu prandaj me një aparat alarmues zjarri që reagon në atë tumin vdekjeprues dhe që të zgjon ty. Kontrolllo alarmuesin e zjarrit rregullisht duke e trusur sustën e proves. Ti mund të lexosh më shumë në fletushkën e këshillave të mira të SBF:it “Alarmues zjarri në banesa”

ZJARRFIKËSE DORE

Është mire ta kesh një zjarrfikëse dore që sa më shpejtë sa të jetë e mundur të fillohet fikja. Të gjithë në familje duhet të dine se si funksionon zjarrfikësja dhe ku është e vendosur. Ti mund të lexosh më shumë në broshurën e këshillave të mira të SBS:it “Zgjedh zjarrfikëse të mire dore”

PLAN EVAKUIMI

Bëre një plan evakuimi dhe lejo fëmijët të marrin pjesë në planifikim. Nëse është e mundur përpiqu të kesh sëpaku dy rrugë evakuimi për të gjithë në familje. Kujdesohu që mund të dilet jashtë nëse fillon zjarri në banesë. Nga ky shkak mos e mbyll dryrin e shtatë pozicioneve nga brenda! Ngjite planin e evakuimit aty ku mund ta shohin të gjithë dhe cakto një vendtubimi jashtë shtëpisë. Përmirëso mundësitë e evakuimit në shtëpi të vogla, për shebull duke instalua një shkallë të posaçme për evakuim.

Listë kontrolli- A është e sigurt shtëpia jote?

- | | | |
|--|---|--|
| <input type="checkbox"/> Largo materialin që ndodhet në afërsi të stufës. | <input type="checkbox"/> Shuaji dritat e qirinje kur ti largohesh nga dhoma. | <input type="checkbox"/> A është i pastruar ventilatori i kuzhinës? |
| <input type="checkbox"/> Nxjerrje kontaktin e aparatit të kafes dhe bukërreshkësin. Instalo me qejf një kohëmatës! | <input type="checkbox"/> Nëqoftëse siguresat prishen rëndomtë- kontakto një elektrikist për lokalizim. | <input type="checkbox"/> A ka paralajmërues zjarri dhe a funksionon ai? |
| <input type="checkbox"/> Shiko që llambat elektrike të kenë numrin- e duhur të vatit dhe që të mos ushtrohet trysje mbi kabllet lidhëse. | <input type="checkbox"/> Nxjerrje kabllën e rrymës dhe të antenës së TV:rit në rast shtrëngate. | <input type="checkbox"/> A ka zjarrfikëse dore në banesë? |
| <input type="checkbox"/> Nderroji prizat e dëmtuara/kontaktet dhe zvidhosi ato. | <input type="checkbox"/> Të kesh kujdes që TV:ri të qëndron në një vend pa pengesa dhe të ajrosur mirë. | <input type="checkbox"/> Pasto me fshesë elektrike prapa frigoriferit dhe/ose frizës. |
| <input type="checkbox"/> Të mos kesh peshqirë ose materiale tjera të ndezshme të shtrira mbi radiatorë për tharje. | <input type="checkbox"/> Hjeke nga TV:ri mbulesën, qirin e stearinës ose të tjerat që mund të shkaktojnë zjarr. | <input type="checkbox"/> Të kesh kujdes që shandanët të qëndrojnë lire nga perdet e të ngjashme dhe që ato të kenë dekorime të pandezshme. |
| | | <input type="checkbox"/> Instalo një ndërprerëse të rrymës të defekteve të tokëzimit. |

NËSE MERR ZJARR TELEFONO GJITHMONË 112

Shoqata Suedeze për mbrojtje nga zjarri është një organizatë anëtarësie që punon për një Suedi më të sigurt nga zjarri. Nëpërmjet të informimit dhe shkollimit ne ndihmojmë njerëz, ndërmarrje dhe organizata që ta mbajnë vetë përgjegjësinë e tyre nga zjarri. **Telefona 08 – 588 474 oo. svbf.se**